



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 51, datë 31.05.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEK SIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. FATMIR KOLA

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin nr. 1062, rruga “26 Nëntori” dhe pallatin nr. 14, rruga “Petraq Boshnjaku” njësia administrative nr. 2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të

Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Aneksin nr.1 “Pallati nr. 1062, Rruga “26 Nëntori”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1062, Rruga “26 Nëntori” dhe Pallatin nr. 14, Rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative nr. 2, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021, përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Fatmir Kola në masën e strukturës së njësisë së banimit 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posacëm për Vlerësimin dhe për Zgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474/8 prot.

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS ✓

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.51 datë 31.05.2022 “Për miratimin e një shtesë në aneksin nr.1, të VKB nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.1062, rruga “26 nëntori” dhe pallatin nr.14, rruga “Petraq Boshnjaku” njësia administrative nr. 2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke përfshirë z. Fatmir Kola”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

